

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI FILOZOFIK Departamenti i Shkencës Politike
Titulli i lëndës:	Partitë politike, zgjedhjet dhe demokracia
Niveli:	Bachelor (BA)
Statusi lëndës:	E obligueshme
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Ligjëratat: të hëneve 9:00-10:30, Salla 202. Për ndryshimet eventuale të orarit do të njoftoheni paraprakisht. Ushtrimet: sipas orarit të shpallur
Mësimdhënësit e lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Arben Hajrullahu Dr. sc. Adem Beha
Detajet kontaktuese:	arben.hajrullahu@uni-pr.edu adem.beha@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kursi <i>Partitë politike, zgjedhjet dhe demokracia</i> është lëndë e ngushtë profesionale e politologjisë (shkencës politike). Zgjedhjet dhe partitë politike cilësohen si pjesa më e rëndësishme e funksionimit të një sistemi demokratik, sepse një sistem i tillë as që mund të paramendohet pa partitë politike. Zgjedhjet dhe partitë politike janë në themel të funksionimit të demokracive liberale. Zgjedhjet kompetitive janë tipari dallues i demokracisë liberale; ato janë jetike për ekzistimin e saj. Demokracitë liberale shpeshherë edhe quhen „demokraci elektorale” mu për shkak të rëndësisë së zgjedhjeve në sisteme të tilla. Në qoftë se për ndonjë fushë mund të thuhet se i takon ekskluzivisht shkencës politike, atëherë kjo padyshim ka të bëjë me zgjedhjet dhe partitë politike. Prandaj, kur kihet parasysh ky fakt, edhe nuk është për t’u habitur që studimet elektorale janë njëra prej disiplinave më të zhvilluara politologjike.
Qëllimet e lëndës:	Përmes lëndës <i>Partitë politike, zgjedhjet dhe demokracia</i> studentët do të fitojnë njohuri lidhur me rolin dhe funksionin e partive politike, proceset e ndryshme zgjedhore, funksionimin e elementeve të ndryshme të një sistemi elektorale apo të sistemeve si tërësi. Përveç kësaj, përmes kësaj lënde studentët do të mësojnë edhe mbi dallimin ndërmjet sistemeve të ndryshme elektorale, për proceset historike evolutive drejt votës demokratike, logjikën e funksionimit të partive politike, llojet e partive politike, funksionet e partive politike, strukturën organizative, transformimet e partive politike, si dhe për tipat e sistemeve partiake dhe për sistemet partiake të disa vendeve më paradigmatisht evropianoperëndimore. Përveç njohurive, studentët do të zhvillojnë edhe aftësitë e tyre hulumtuese dhe analitike, për t’u aftësuar që të identifikojnë elemente më të rëndësishme në proceset zgjedhore dhe ato të partive politike. Gjithashtu, përmes kësaj lënde studentët do të fitojnë dije dhe aftësi që do t’u ndihmojë atyre të punojnë në partitë politike ose në organizimin e zgjedhjeve.

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit, studentët duhet të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> të kuptojnë rolin dhe funksionin e partive politike në sistemet demokratike bashkëkohore; të kuptojnë llojet dhe tipat e ndryshme të partive politike historike dhe ato bashkëkohore; të fitojnë dije elementare mbi funksionimin e strukturës së brendshme të partive politike bashkëkohore; të kuptojnë nocionin, rëndësinë dhe funksionet e shumta të zgjedhjeve në sistemet e ndryshme politike; të identifikojnë elementet kyçe të sistemeve zgjedhore, siç janë: ndarja në zona elektorale, proceset e konkurrimit, proceset e votimit, si dhe metodat e shndërrimit të votave në mandate, etj.
---	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	15 min.	8	2
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokuiume, seminare	2	9	18
Detyra të shtëpisë	2	2	4
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	12	24
Përgatitja përfundimtare për provim	2	12	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	1	3	3
Projektet, prezantimet ,etj	1	15	15
Totali			150

Metodologjia:	Kursi do të zhvillohet nëpërmjet ligjëratave, diskutimeve në seminare, punës ekipore/grupore, detyrave me shkrim. Aktiviteti i studentëve gjatë zhvillimit të kursit do të shpërblehet me pikët shtesë që hyjnë në notën përfundimtare.
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> deri në 15 pikë nga vijueshmëria e rregullt dhe pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime; deri në 35 pikë nga prezantimi i një teme individualisht apo në grup (maksimum 2 studentë për grup); deri në 50 pikë ese (rreth 2.000 fjalë, të paktën 5-10 burime kredibile) lidhur me prezantimin e mbajtur në klasë. <p>ME RËNDËSI:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në rast të mos përfundimit të detyrave studentët rekomandohen që të mos i nënshtrohen provimit final për deri sa të përfundohen të gjitha detyrat dhe të mbizotërohen temat e lëndës. Më shumë se tri mungesa gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve nota përfundimtare do të zbritet automatikisht për një shkallë.

- Të gjitha detyrat e dorëzuara me shkrim duhet të jenë të formatuara siç vijon: Madhësia e shkronjave në tituj 16, nëntituj 14, tekst 12. Hapësira mes rreshtave duhet të jetë 2 (“Double Space”). **Punimet që nuk respektojnë këto rregulla të formatimit nuk do të pranohen!**

Vërejtje:

- Vijueshmëria e rregullt në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme;
- **Pikët e arritura gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve vlejnë vetëm në afatin e parë në testin përfundimtarë të ofruar pas ligjëratës;**
- Në rast të mospërfshirjes së suksesëshme në ushtrime nota maksimale që do të mund të arrihet në këtë lëndë do të jetë 7 (shtatë).

Vlerësimi

90 – 100 pikë

80 – 89 pikë

70 – 79 pikë

60 – 69 pikë

50 – 59 pikë

45 – 49 pikë

0 – 44 pikë

Nota përfundimtare

10 – shkëlqyeshëm

9 – shumë mirë

8 – mirë

7 – kënaqshëm

6 – mjaftueshëm

5 – pamjaftueshëm për notën kaluese; kërkohet edhe pak punë nga studentit.

5 –pamjaftueshëm; kërkohet shumë punë për të fituar notën kaluese dhe kreditë.

Literatura	
L i t e r a t u r a	<ul style="list-style-type: none"> • Adem Beha (2016), Mes Stabilitetit dhe Demokratizimit, Zgjedhjet, partitë politike dhe demokracia brendapartiake, Friedrich Ebert Stiftung & Centre for Political Courage. • Adem Beha, Bekim Baliqi (2014), Elections: A Retrospective in Kosovo. Prishtinë, Konrad Adenauer Stiftung. • Andrew Heywood (2008), Politika, Brezi '81, Prishtinë, faqet 205-268. • Andrew Reynolds dhe të tjerët, (2005), Electoral System Design: The New International IDEA Handbook, (libri elektronik në pdf.) ose versioni i vitit 1997, i botuar edhe në shqip më 2000: Manual i International IDEA për hartimin e sistemeve elektorale, SFINGA, Prishtinë, përkthyes S. Çapriqi. • Ben Reilly (2001), Democracy in Divided Societies: Electoral Engineering for Conflict Management, Cambridge: Cambridge University Press. • Ben Reilly (2002), Electoral Systems for Divided Societies, Journal of Democracy. • Daniel-Louis Seiler (2009), Partitë politike. Tiranë: UET/Press. Përkth. B. Hyska. • Leon Malazogu, Brenna Gautam (2014). Busolla ideologjike e Kosovës. Hartë e orientimit të partive politike, Prishtinë, Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D). • Materiali mbi partitë politike nga D@dalos: http://www.dadalos.org (material i përpunuar dhe i përmbledhur në një dokument pdf). • Norberto Bobbio (2007), E djathta dhe e majta: Gjykime dhe kuptime të një dalluese politike, Instituti i Dialogut & komunikimit (titulli i origjinalit: Destra e sinistra, 1995). • Russell J. Dalton, David M. Farrell, Ian McAllister (2011). Political Parties and Democratic Linkage: How Parties Organize Democracy. Oxford University Press. Kapitujt 1-3.
L i t e r a t u r a S h t e s ë	<ul style="list-style-type: none"> • Afrim Krasniqi (2008), Partitë politike dhe sistemet politike, Tiranë. • Alan Ware (1995), Political Parties and Party Systems, Oxford University Press. • Andrea Römmele, David M. Farrell, Piero Ignazi (2005), Political Parties and Political Systems: The Concept of Linkage Revisited, Praeger. • Arben Qirezi (2014), Efektet politike të sistemeve zgjedhore: Simulim me rastin e Kosovës, CPC Paper Series, Paper #1, Prishtinë (http://old.cpc-ks.org/repository/docs/CPC_Paper1_Efektet_Politike_t%C3%AB_Sistemeve_Zgjedhore_Simulim_me_Rastin_e_Kosov%C3%ABs_460664.pdf). • Arend Lijphart (1994), Electoral Systems and Party Systems, Oxford University Press. • Arend Lijphart, Bernard Grofman (1984), Choosing an Electoral System: Issues and Alternatives, New York: Praeger. • Artan Fuga (2003), Majtas jo djathtas: ndryshimi te socialistët shqiptarë në këndvështrimin e filozofisë politike bashkëkohore. Tiranë, Ora. • Christina Isabel Zuber (2013), Beyond outbidding? Ethnic party strategies in Serbia, Party Politics: 19, 758. • Conor P'Dwyer (2004), Runaway State Building: How Political Parties Shape States in Postcommunist Eastern Europe, World Politics, Vol.64. No.4. • Detlef Jahn (2011), Conceptualizing Left and Right in comperative politics: Towards a deductive approach, Party Politics 17:745. • Giovanni Sartori (1976), Parties and Party Systems: A Framework for Analysis. Cambridge: Cambridge University Press. • Giovanni Sartori (1994), Comparative Constitutional Engineering, pjesa e parë "Electoral Systems", faqet 1-79. • Grigorii V. Golosow (2011), Party system classification: A methodological inquiry. Party Politics, 17:539. • Jack Bielasiak (2002), The Institutionalization of Electoral and Party System in Postcommunist States, Comperative Politics, Vol. 34, No. 2.

- James Toole (2007), The Historical Foundations of Party Politics in Post-Communist East Central Europe, Europe-Asia Studies, Vol. 59. No.4.
- John Ishiyama, Marijke Breuning (2011), What's in a name? Ethnic party identity and democratic development in post-comunist politics, Party Politics, 11:223.
- Larry Diamond, Richard Gunther (2001), Political Parties and Democracy (A Journal of Democracy Book), The John Hopkins University Press and the National Endowment for Democracy.
- Michael D. McDonald, Ian Budge (2005), Elections, Parties, Democracy. Oxford University Press.
- Norris Pippa (2003), Electoral Engineering: Voting Rules and Political Behavior, botim elektronik.
- Petra Schleiter, Alisa M. Voznaya (2012), Party system competitiveness and corruption, Party Politics.
- Reginald Austin, Maja Tjernström (2003), Funding of Political Parties and Election Campaigns, IDEA Handbooks.
- Richard Gunther, Josi Ramsn Montero, Juan Linz (2002), Political Parties: Old Concepts and New Challenges (Comparative Politics), Oxford University Press.
- Reeve and A. Ware, Electoral Systems (1992), A Comparative and Theoretical Introduction, London and New York: Routledge.
- Richard Gunther, Larry Diamond (2003), Species of Political Parties: A New Typology Party Politics, Vol. 9. No. 2.
- Robert Michels (1966), Political Parties. Mund të lexohet faqe për faqe në: http://www.amazon.com/gp/reader/0029212502/ref=sib_dp_pt/102-2791219-0675307#reader-page
- Ronald J. Hrebemar, Robert C. Benedict, Matthew J. Burbank (1999), Political Parties, Interest Groups, and Political Campaigns, Westview Press.
- Steven G. Calabresi (1994), Political Parties as Mediating Institutions. The University of Chicago Law Review, Vol. 61, No. 4.
- Schedler (2002), Elections without Democracy: The Menu of Manipulation, Journal of Democracy 13.2.

Plani i detajuar i mësimit:	
Java	Ligjërata
Java e parë:	Njoftimi i studentëve me lëndën, literaturën bazë, modalitetet teknike, qëllimet e kursit dhe me obligimet e studentëve gjatë kursit.
Java e dytë:	Llojet historike dhe bashkëkohore të partive politike: partitë elitiste (partitë e honorarit), partitë e masave, partitë populiste (<i>catch all</i>) dhe partitë profesioniste (karteliste).
Java e tretë:	Funksionet e partive politike; Roli i partive politike në demokracinë përfaqësuese.
Java e katërt:	Organizata e partive politike. Partitë politike dhe ideologjia. Fillimi i prezantimit të temave nga studentët, vazhdon edhe në javët në vijim.
Java e pestë:	Transformimi i partive politike. Kritikat bashkëkohore ndaj partive politike. Partitë politike në demokracitë e reja.
Java e gjashtë:	Sistemi partiak. Sistemet partiake të disa vendeve të Evropës Perëndimore. Week of April 23 rd , Guest Lecturer Assis. Prof. Vratislav Havlík (Masaryk University, Czech Republic): <ul style="list-style-type: none"> ➤ Political system of the Czech Republic, Czech political parties and their Europeanization ➤ Gap between political party and its elites. How far does the socialization of national elites in Brussels matter?

<i>Java e shtatë:</i>	Nocioni, rëndësia dhe funksionet e zgjedhjeve në sistemet demokratike dhe sistemet autoritare.
<i>Java e tetë:</i>	Historiku i së drejtës zgjedhore: evolucioni nga forma të ndryshme jodemokratike deri tek e drejta e votës demokratike (vota e përgjithshme, e barabartë, e drejtpërdrejtë dhe e fshehtë).
<i>Java e nëntë:</i>	Elemente të sistemeve zgjedhore: ndarja në zona elektorale; procesi i garës zgjedhore (kandidaturat individuale dhe listat); votimi; përlllogaritja e votave (metodat e shndërrimit të votave në mandate).
<i>Java e dhjetë:</i>	Sistemet mazhoritare: i pari i listës merr postin, sistemi dyraundësh, vota bllok, vota bllok partiake dhe vota alternative.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Sistemet proporcionale: sistemet e listave dhe sistemi votës së vetme të transferueshme.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Sistemet e kombinuara: sistemet paralele, sistemet kompensuese, sistemet e zgjedhjeve proporcionale të personalizuar.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Proceset elektorale.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Përsëritje dhe diskutim i eseve.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Plagjiatura dhe mashtrimet e tjera që nuk janë të pajtueshme me normat etike të jetës akademike do të ndëshkohen rreptësisht.</p> <p>Të gjitha punimet e dorëzuara duhet të jenë rezultat i punës suaj. Plagjiazëm konsiderohet kopjimi i punës së bërë nga të tjerët dhe paraqitja e saj si punë e juaja. Çdo rast i plagjiazmit rezulton automatikisht me notë negative dhe do të pasojnë masa disiplinore që mund të shprijn deri te marrja e së drejtës për të qenë student/e në Universitetin e Prishtinës.</p>	